



BSPSH(Bashkimi I Sindikatave te Pavarura te Shqiperise) ne daten 5.12.2015 organizoi fushaten me slogan " Na llogarisni dhe ne" ne Shqiperi me bashkpunim dhe bashkfinancim me Konfederaten Nderkombetare (ITUC) dhe ne Konfederaten e Suedise (Union to Union), ku moren pjese 150 gra, anetare te BSPSH prej te gjithe federatave dhe rajoneve. Sigurisht ne kete fushate moren pjese dhe perfaqesues nga organizata ILO e Shqiperise, perfaqesues nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise.

Presidenti I BSPSH, z. Gezim Kalaja theksoi rëndesine e fuqizimit te rolit te grave ne vendim marrje, ne pozicione udheheqese, ne politikberje, por dhe ne rëndesine qe ka barazia gjinore, kunder diskriminimit ne vendet e punes, per pune te mira, per barazi ne pagat midis meshkujve dhe femrave, por edhe per pune te denja sipas direktivave te Bashkimit European dhe sipas strategjise te ndjekur nga ITUC.

Presidenti Kalaja theksoi se BSPSH ka arritur pjesemarrjen e grave ne strukturat udheheqese me 35 %, 5 % me shume sesa eshte parashkruar ne statutin e ITUC. Gjithashtu ne perputhje me vendimet e Kongresit te 3 te ITUC z. Kalaja mori vendimin te arrije objektivin me antaresimin e 5 % me shume grave ne Kongresin e 4 te ITUC ne 2018, kshuqe perfaqesimi I grave ne BSPSH te arrije ne 40 %.

Znj. Arjola Alike, perfaqesuese e BSPSH, theksoi rendesine e fushates me slogan "Na llogarit dhe ne" si nje nisme e rendesishme e ITUC, por edhe rendesine e ketyre fushatave, me keto dimensione, per te rritur numrin e grave ne pozicione udheheqese, ne politikberje, por edhe ne strukturat qeverisjeje. Qellimi I kesaj fushate ishte te rriste me 5 % me shume rolin e gruas ne strukturat udheheqese te BSPSH, shkruar ne statutin e ketij te fundit, ne statutin e BSPSH por edhe ne baze te vendimeve te Kongresit te 3 te ITUC. Te gjitha pjesemarresit shprehen gatishterine e tyre per vazhdimin e kesaj perpjekjeje ne nivel kombetar ne te gjitha federatat dhe rajonet e BSPSH. Ne kete takim gjithashtu u nenshkrua nje deklarate midis BSPSH dhe federates per te rritur antaresimin e grave ne sindikata, rekrutimin e te rejave, por edhe trajnimitin e tyre per pozicione udheheqese, kualifikime nepermjet seminareve dhe trajnimeve, bashkepunimit me sindikatat ne rajon, shkembimit te pvojave per barazine gjinore, fuqizimin e rolit gruas, por edhe kunder diskriminimit ne vendet e punes, dhe page te mire e pune te mira. Ne morem iniciativen qe deri ne Kongresin e 4 te ITUC dhe ne Kongresin e 6 te BSPSH te rrisim me 40% perqindjen e grave lider ne BSPSH. Tani me shume gra mund te bashkohen ne sindikate si anetare, aktiviste dhe lider kur sindikata reflekton sakte diversitetin gjinor ne udheheqjen e tyre. Duke promovuar rolin gruas ne udheheqje, sindikata rrit kapacitetin te ndertoje fuqi punetore dhe te marre me shume te drejta per punetoret. Duke njohur dhe duke vleresuar kapacitetet udheheqese te gruas ne bejme nje investim ne demokraci dhe ne forcen e levizjes tone. Me shume gra ne udheheqje rrit mundesine e sindikatave per te arritur, organizuar dhe mobilizuar me shume anetare gra dhe aktiviste. Duke promovuar rolin e gruas ne udheheqje, sindikatat behen me perfaqesues e fuqise punetore ne vendet e tyre respective. Te gjitha federatat moren vendimin per te zhvilluar fushaten me slogan " Na llogarisni dhe ne" ne cdo ndermarrje dhe ne cdo rajon per te informuar cdo anetar per deklaraten e kesaj fushate.

Gjithashtu ne kuader te Dites Nderkombetare kunder dhunes ndaj grave (25.11 – 10.12.2015), BSPSH mbeshteti fushaten " 16 dite kunder dhunes gjinore" ku pjese e zgjidhjes jane meshkujt. Eliminimi I dhunes gjinore si ai psikologjik, fizik e seksual, ndikon direkt ne rritjen e perqindjes te pozicioneve udheheqese te grave, sepse pengesa eshte ne dhunen me baze gjinore.

Presidenti I BSPSH Gezim Kalaja theksoi se statistikat e dhunes ndaj grave ne Shqiperi jane ne perqindje shume te larte, e kjo vjen si pasoje e mungeses se informacionit, te moskualifikimit arsimor, te ardhura te uleta qe ndikojne ne pavaresine financiare te grave. Bashkepunimi midis sindikatave dhe shoqerise civile por edhe qeverise duhet te jete ne nje unifikim te legjislacionit Shqiptar ne baze te Direktivave dhe Legjislacionit te Bashkimit European, Te Konventes te ILOS dhe Konventes Per te Drejtat E Njeriut. Ne kete fushate te rendesishme perfaqesuesi I Forumit Rinor te BSPSH, z. Bruno Hoxha, kerkoi mbeshtetje nga Presidenti I BSPSH z. Gezim Kalaja te marre angazhime edhe per forumin rinor. Per kte arsye ato nenshkruan fushaten rinore me slogan "Organizohu" te Platformes Rinore. Kjo fushate permban disa pika te rendishme te cilat jane; pune te denja per rinine, papunesia e te rinjve, pasiguria e te rinjve ne pune, te drejtat e te rinjve, fokusimi I femrave te reja, mbrojtja sociale e punetoreve te rinj, siguri shendetesore ku

perfshihet edhe HIV-AIDS, rroga per punetoret e rinj duke perfshire dhe rrogat minimale, dhunes kunder grave, pjesemarrjen e te rinje ne sindikata, por edhe aksesin ne kualitetin mesimor dhe trajnor.

Kjo fushate do te mbahet ne 2016 duke patur si synim rritjen me 40 % te te rinjve ne BSPSH. Ne fund te aktivitetit, 150 gra regjistruan nje video me sloganin e fushates "Na llogarisni dhe ne". Mbase regjistruan videon, pjesemarrjesit ishin te ftuar nga BSPSH per nje dreke ne Kompleksin "Tropikal", e cila u financua me mbeshtetjen e ITUC por edhe te Sindikates te Pavarur te Minatoreve te Shqiperise.





